




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.398/350-42458 datë: 29.09.2020
REFERENC-Ë:	07Nr.350/42458 datë: 09.09.2020
PËR/TO:	Valdet Kuçi, Besnik Kuçi dhe Binak Kuçi, Rruga "Brigada 123" - Suharekë
KOPJE/copy:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI <i>Zyrtare e lartë për ndërtimtari:</i> Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Lejen Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/42458 datë: 09.09.2020 nga **Valdet Kuçi, Besnik Kuçi dhe Binak Kuçi nga Suhareka**, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim afraizëm, me etazhitet P+1, pjesë e parcelës **02353-2** pronë e Valdet Kuçi, Binak Kuçi, Besnik Kuçi, Arben Kuçi, Valbona Kuçi dhe Shaban Kuçi me numër referues të çertifikatës 11-463-3548/2020, datë: 29.09.2020, pjesë e parcelës **02354-2** pronë e Valdet Kuçi, Binak Kuçi, Besnik Kuçi, Arben Kuçi, Valbona Kuçi dhe Shaban Kuçi me numër referues të çertifikatës 11-463-3548/2020, datë: 29.09.2020, dhe **02355-4** pronë e Valdet Kuçi, Binak Kuçi dhe Besnik Kuçi me numër referues të çertifikatës 11-463-3548/2020, datë: 29.09.2020, vendi i quajtur Gradina, Zona Kadastrale Suharekë, sipas pëlqimit mbi të drejtën e ndërtimit LRP.Nr.5331/2020 datë 09.06.2020 dhe Nr.HY 515/2020 datë 01.07.2020. Andaj pas shqyrtimit të lëndës ky organ vendosi, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**





Data: 29.09.2020

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.398/350-42458

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Valdet Kuçi, Besnik Kuçi dhe Binak Kuçi nga Suhareka, DUP lëshon këtë:

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Valdet Kuçi, Besnik Kuçi dhe Binak Kuçi	Nr. Personal:	
Adresa:	Rr. " Brigada 123", Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350/42458 datë: 09.09.2020

Emri i Projektit:	OBJEKT AFARIST		
Emri i Projektuesit:	N.P.N "D-PROJECT"		
Adresa:	Komuna e Parisit Lamella 3 Hyrja 1 Banesa nr 2, Prizren		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II			
Adresa: Rr. " Brigada 123"-SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Sipas cert. me nr. të lëndës : 11-463-3548/2020 dt. 19.09.2020	pjesëe parcelës 02353-2, pjesë e parcelës 02354-2 02355-4	Y= 7485213.846 Y= 7485223.454 Y= 7485231.848 Y= 7485222.311	X=4690420.543 X=4690427.022 X=4690414.609 X=4690408.121

Lloji i ndërtimit të propozuar:
Objekt Afarizëm
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Prizren, 29.09.2020

Drejtor

Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim

Kategoria II			
Sipërfaqja e përgjithshme bruto e objektit:			
389.00 m ²			
Gabariti:	11.8m' x 15.0m'	Katshmëria:	P+1
Vija rregullative:	Nga aksi i rrugës "Brigada 123" 16.0m'	Vija ndërtimore:	Nga aksi i rrugës "Brigada 123" 19.0m'

Përshkrimi	
Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Valdet Kuçi, Besnik Kuçi dhe Binak Kuçi nga Suhareka i lejohej ndërtimi i objektit me destinim afarizëm me etazhitet P+1. Lokacioni i objektit është në kuadër të PZhU-së, 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelat kadastrale 02353-0, 02354-0 dhe 02355-4, është tokë ndërtimore me destinim zonë qendrore banimore. Objekti është planifikuar të ndërtohet pranë rrugës "Brigada 123" me destinim afarizëm sipas hartimit të projektit nga byroja projektuese: N.P.N "D-PROJECT", Prizren. Objekti ka karakter të përhershëm me katshmëri P+1. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Aktvendimit mbi Kushtet Ndërtimore të lëshuara nga ky organ:07Nr.232/350-17892 datë 23.07.2020 Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: - Informata mbi Lejen Ndërtimore; - Informata mbi Projektuesin; - Informata mbi Kontraktuesin; - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore; - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit; - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent; - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit; - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit; - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur; - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit; - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë	

10.05.2024

10.05.2024

10.05.2024 10.05.2024 10.05.2024

10.05.2024

10.05.2024 10.05.2024

(7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rastë të mos respektimit të Njoftimit rreth Kushteve ndërtimore, Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimi teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar s y e t i m

Aplikuesi **Valdet Kuçi, Besnik Kuçi dhe Binak Kuçi nga Suhareka**, përmes kërkesës 07Nr.350/42458 datë:09.09.2020, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim afarizem, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimin mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.232/350-17892 datë 23.07.2020 (kopje)
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.128/20, datës:12.08.2020 lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vlerësim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit-Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.2118 datë:07.09.20.
- Pëlqim Sanitar-nga Inspektori i Sanitarisë 09Nr.702 datë:20.08.2020.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.701 datë:20.08.2020.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.1074, datë:03.09.2020.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri, DSHPME, Sektori i parandalimit të zjarrit Nr.03/03-79, datë:20.08.2020.

- Kordinatat e vendosjes se objektit sipas skicës së terrenit Nr.P.29/2020 datë 08.06.2020 të punuar nga gjeodeti i licensuar Adriatik Fetiu.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe certifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform PZhU-së, 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.


Sipas Njoftimit 07Nr.378/350-42458 datë 21.09.2020, parashtruesit të kërkesës i është caktuar lartësia e pagesës për leje ndërtimore në shumën prej 1,089.20€ dhe se për pagesën e kryer janë sjellë dëshmia nga IFJB Capital sh.p.k me datë 22.09.2020, sipas faturës komunale nr.0000582 të datës 21.09.20.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.398/350-42458 datë: 29.09.2020*

Vendimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës;
Inspektoratit të Komunës;
Dosjes së DUP-së



Drejtori i Drejtorisë:
Sanie KUQI

